



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 23, datë 22.04.2022

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË DHJETË TË 16 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT
DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE
INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS
PROJEKTIT MODEL

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.8, datë 28.01.2021 “Për miratimin e kontratës model për kalimin e masës së grantit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 sipas projekteve model nga Bashkia Durrës tek përfituesi” dhe sipas relacionit të hartuar nga Komsioni i posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së dhjetë të 16 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model, pasqyruar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse

e tij, hartuar nga Komsioni i posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.04.2022

ANEKSI I. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA MASA E GRANTIT TË RINDËRTIMIT

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	VLERA E GRANTIT
1	R1	AMARILDA	JUSUF	FEJZO	4	2+1	2,617,558
2	R2	KRESHNIK	AHMET	BODLLI	10	3+1	3,428,958
3	R4	AGRON	FERHAT	ELEZI	1	1+1	2,236,552
4	R4	VAHID	MUHAMED	ELEZI	4	2+1	2,617,558
5	R4	LILIANA	SEIT	ELEZI	1	1+1	2,236,552
6	R4	HALIT	REXHEP	BRAHAJ	6	3+1	3,428,958
7	R4	RENALD	LEONARD	KOKA	3	2+1	2,617,558
8	RRASHIBULL	BALI	RRUSTEM	XHIBEXIII	3	2+1	2,617,558
9	RRASHBULL	IDRIZ	DEMIR	XHAFI	2	1+1	2,236,552
10	KATUNDIRI	SUGORE	DED	NDOCI	1	1+1	2,236,552
11	KATUNDIRI	ALI	HALIL	GASII	2	1+1	2,236,552
12	KATUNDIRI	FASLLI	GANI	SHALA	3	2+1	2,617,558
13	KATUNDIRI	PJETER	PASKO	SINJARI	6	3+1	3,428,958
14	KATUNDIRI	SHEFIT	MUSTAFA	KUCI	2	1+1	2,236,552
15	MANEZ	AGIM	KASEM	KOCI	6	3+1	3,428,958
16	ISHEM	PREN	NIKOLL	BRAHJA	4	2+1	2,617,558

TARIA
DURRES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 38/prot.
2



Durrës, më 05.05.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.23 datë 22.04.2022 “Për miratimin e listës së dhjetë të 16 subjekteve përfituese të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, sipas projektit model”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

